REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 864/20
Datë/Datum. 29.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: *(**Komuna FERIZAJT**)*

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: *(**656-20-4400-5-2-1**)*

Sa i përket tenderit për *(**Ndërtimi i objektit të QMF-së, fsh. Prelez.**)*

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

G&A CONSULTING SH.P.K
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Sali Nivica Nr.19
(Adresa)

Prishtinë — *10000*
(Vendi) — *(Kodi postar)*

049/190888
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Gentian Abazi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

ga.consulting15@gmail.com
(Adresa elektronike)

29.10.2020
(Data e parashtrimit të ankesës)

SH.P.K G&A CONSULTING
(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

1. *Njoftimi per kontrate dt: 19.08.2020*
2. *Njoftimi per Anulim dt: 05.10.2020*

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [X] Jo [ ]

Proces verbali i hapjes se tendereve i pranuar : 10.09.2020

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [ ] Jo [X]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] Jo [ ]

Kemi dorezuar Kerkesen per Rishqyrtim me daten 12.10.2020 , dhe nuk kemi pranuar asnje pergjigje ose vendim te kerkeses sone per rishqyrtim nga Autoriteti Kontraktues Komuna e FERIZAJT

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 42 i LPP-së
Neni 52 i LPP-së
Neni 54 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 62 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së
Neni 108-A i LPP-së

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ankesa jonë bëhet per arsye se AK ka bërë Njoftimin per Anulimin e aktivitetit te cilin Anulim ne e kundershtojme pasi qe eshte i pa bazuar dhe i kunderligjshem duke na diskriminuar neve si OE pjesemarres ne kete tender dhe te cilet kemi ofruar oferten me te lire te pergjegjshme, perveq se ka anuluar AK ka vazhduar diskriminimin ndaj nesh duke mos na ofruar dhe duke mos na shqyrtuar Kerkesen per Rishqyrtim qe kemi dorezuar prane AK-se ne faqen e e-prokurimit dhe ne emailin zyrtar, per keto dokumente qe ju kemi drejtuar AK-se nuk na eshte pergjigjur ne asnjeren nga keto duke i injoruar te drejtat tona.

AK ka vepruar kundër LPP nenit 10 pika 3, 4,5 , NUK NA KA OFRUAR Qasje ne dokumete edhe përkundrazi, kerkeses qe kemi dorëzuar tek AK me datën, 09.10.2020 nuk kemi marr asnje përgjigje qka AK ka vepruar kundër nenit 10 te cilin po e citojme : me poshtë po citojmë:

3. .Me kërkesën me shkrim nga cilado palë e interesit, autoriteti kontraktues i siguron qasje të arsyeshme palës që kërkon të ketë qasje në të dhënat e përshkruara në paragrafin 1 dhe 2

të këtij neni, përveç informatave sekrete afariste të cilat vërtetohen si të tilla nga një autoritet përkatës që kanë të bëjnë me çfarëdo aktiviteti të prokurimit që është mbyllur. Për qëllime të paragrafit 3. të këtij neni, aktiviteti i prokurimit konsiderohet i mbyllur (i) në datën e publikimit të njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit, (ii) në datën e dhënies së kontratës në rast të tenderëve sipas nenit 37 të këtij ligji, ose (iii) nëse aktiviteti i prokurimit formalisht është anuluar ose përndryshe është përfunduar para dhënies ose zgjedhjes së fituesit, atëherë në datën e njoftimit për anulim sipas paragrafit 2. të nenit 62 të këtij ligji ose në datën kur aktivitetet ishin përmbyllur

4. Autoriteti kontraktues do të sigurojë qasjen e kërkuar nga paragrafit 3. i këtij neni në mënyrë të rregullt, të qetë, dhe pa pengesa. Sidoqoftë, autoriteti kontraktues mundet që të mbikëqyrë qasjen në fjalë ose të marrë masa të arsyeshme për të ruajtur integritetin e të dhënave.

5. Autoriteti kontraktues, me kërkesë të një pale të interesuar, do të bëjë dhe do t'i sigurojë palës së tillë të interesuar një kopje të çfarëdo materiali në të cilin pala e tillë e interesuar ka të drejtë qasjeje sipas paragrafit 3 të këtij neni.

AK, Nuk na ka njoftuar me rezultatet e tenderit , ne nuk kemi Pranuar anjs Njoftim nga AK per rezultatet e Vlersimit qka ne kemi qene me oferten me te lire. AK ka vepruar kunder nenit 59 te LPP, por qe duke vepruar kunderligjshem ka anuluar procedure pa asnje Argument jorelevant sikur eshte bashkefinancimi, qka nuk eshte e qendrueshme per nje AK, sepse ajo mund te behet edhe pas nenshkrimit te kontrates, por ky nuk ka qene argumenti por preteksi I krijuar me qellimin e anulimit te aktivitetit, per arsyet qe nuk dihen, duke vepruar kunderligjshem.

AK ka vepruar edhe kunder nenit 62, per perfundimin e aktivitetit, pasi qe nuk ka pasur asnje argument,po se vetem ka shkuar direkt ne Anulim

AK nuk ka prezeentuar nje Vendim mbi konfirmimin edhe nga ZKA per anulimin e procedures, por permend vetem nje Kerkese nga Njësia e Kerkuese.

Ne si OE I interesuar dhe me oferten me te lire, nuk jemi Njoftuar me Leter standarde per njoftim te OE te sukseshem, te pasukseshem dhe te eleminuar

Kërkojmë nga OSHP qe te shqyrtoje ankesen tonë pasi qe AK ka demtuar haptas interesin tone material dhe afarizmin e biznesit tone duke vepruar kunderligjshem dhe duke shkelur nenet e LPP-se te cekura me lart, pasi nuk kemi pranuar qasje ne dokumente zyrtare , AK nuk eshte pergjigjur ne interesimin tone qe dmth ka vepruar kunder nenit 10 te LPP-se.
Ne kemi drejtuar kerkesen per rishqyrtim prane AK-se e cila nuk ka shqyrtuar as nuk na ka njoftuar per rezultatin ose pergjigjen e kesaj kerkese duke vepruar ne kundershtim me nenin 108-A te LPP-se.
Ne kemi kerkuar permes kerkeses per rishqyrtim zgjidhjen e mosmarveshjeve preliminare duke shfrytezuar te drejten e ankeses ne shkallen e pare por qe kemi qene teresisht te injoruar nga ana e AK-se andaj kemi qene te detyruar qe kete ankes ta drejtojme prane OSHP-se.
Duke qene pale e demtuar dhe AK duke qene subjektive ndaj nesh ne kundershtim me nenet e cekura ka bere Anulimin e tenderit me tendence duke demtuar hapur interesin material.
AK nuk ka prezentuar nje Vendim te aprovuar nga ZKA i cili ka aprovu kete anulim te tenderit pasi qe ZPP ka bere Anulimin e kunderligjshem te procedures se prokurimit vetem permes nje kerkese nga njesia kerkuese e cila kerkese nuk ka qene e argumentuar dhe nuk ka qene relevante dhe e bazuar per te bere Anulimin ne fjale, por aty eshte perdorur nje arsyetim qe me shume eshte nje pretekst per te na demtuar neve si OE.
ZPP ka bere Anulimin pa e perdorur formularin e Njoftim-Vendimit mbi rezultatet e tenderit ose mbi arsyeshmerine e Anulimit pasi qe aty permes Njoftim-Vendimit eshte

dashur te prezentoj kerkesen e njesise kerkuese dhe aprovimin e Anulimit nga ana e ZKA-se
Ne arsyetimin per Anulimin se gjoja ngastra kadastrale eshte e destinuar per Afarizem Tregti dhe Industri . AK bie ndesh me veten pasi qe para shpalljes se tenderit Njesia Kerkuese e ka ofruar ose eshte dashur ta ofroje nje flete poseduese mbi pronesine dhe destinimin e prones. Andaj ky arsyetim eshte i paqendrueshem pasi qe bazuar ne ligjet e zbatueshme me nje kerkese Kuvendit Komunal mund te ridestinohet veprimtaria e ngastres kadastrale.

Duke pasur parasysh të gjitha arsyet ligjore që u përmendën më lartë, kërkojmë nga Bordi i Ankesave te OSHP-se që të merrni:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar Ankesa e OE **"G&A CONSULTING"** ***SH.P.K***
ANULOHET njoftimi per Anulimin e procedures se prokurimit nga ana e Komunes FERIZAJT me daten 05.10.2020
DETYROHET komuna e FERIZAJT qe te vleresoje dhe te shpall rezultatet e tenderit ne fjale

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Kompania jone pëson dëme te konsiderueshme përkundër këtij viti te vështire, ne kemi te punësuar dhe paguajmë paga mujore, dhe se rrezikohemi te afarojme suksesshëm. Demet materiale arrijn ne shumen prej 10,000 €

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

*a) një kopje të publikimit të "**Njoftimit për Kontratë**"*
*b) një kopje të publikimit për" apo "**Njoftimit për Anulim**".*
*c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.-**NUK E KEMI PRANUAR***
*d) një kopje të **Procesverbalit të hapjes publike** të tenderëve, nëse aplikohet.*
*e) Kopjet e skanuara te kërkesës **për QASJE** ne dokumentet e rezultatit te tenderit*
*f) Kopja e **Kerkeses per Rishqyrtim** derguar AK-se me datë: 12.10.2020*
*g) **Letra rikujtuese** derguar AK-se (Krpp-se) me datën: 19.10.2020*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*